


01-389



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-37349/25 dt. 14.03.2025, të kërkesit/subjektit juridik & investitorit “Olti Trasing” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emëruar si “Donika II” ndërtuar në kuadër të bllokut urban “B1” dhe B2” të tërësisë “B”, të Planit Rregullues “Lakërishte”, në rrugën “Besa Imami”, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 29.05.2025, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET pronarit/subjektit juridik & investitorit “Olti Trasing” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810514291, me përfaqësues Ragip Mustafa, sipas kërkesës 05Nr. 391/02-37349/25 dt. 14.03.2025, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si “Donika 2”-“Ndërtesa A” me etazhitet 4B+P+19ET, “Ndërtesa B” me etazhitet 4B+P+19ET, “Ndërtesa C1-C2” me etazhitet 4B+P+22ET dhe “Ndërtesa D” me etazhitet 4B+P+12ET, të ndërtuar sipas Vendimeve të Lejeve Ndërtimore 05 Nr. 351-27814/20 dt. 09.10.2009, (faza e parë-pjesa e nëntokës së kompleksit), 05-035-71040 dt. 15.05.2013, (faza e dytë e ndërtimit), 05-035-232898 dt. 20.12.2013 (faza e tretë e ndërtimit) dhe 05Nr.351/05-37066/23 dt. 20.05.2024 (ndryshim-plotësim&zgjerim), në kuadër të bllokut urban “B1” dhe B2” të tërësisë “B”, të Planit Rregullues “Lakërishte” në Prishtinë konkretisht në parcelat kadastrale nr. 7228-1 & 7228-2 ZK. Prishtinë si dhe me trajtim përmes transferit të parcelës kadastrale 7228-3, ZK. Prishtinë.**

**II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Besa Imami” ku janë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 30, 32 dhe 34 në Prishtinë. dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.**

**III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.**

**IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.**

## A r s y e t i m

Pronarit/subjektit juridik & investitorit “Olti Trasing” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810514291, me përfaqësues Ragip Mustafa, me kërkesën me 05Nr. 391/02-37349/25 dt. 14.03.2025, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara “Donika 2”-“Ndërtesa A” me etazhitet 4B+P+19ET, “Ndërtesa B” me etazhitet 4B+P+19ET, “Ndërtesa C1-C2” me etazhitet 4B+P+22ET dhe “Ndërtesa D” me etazhitet 4B+P+12ET, të ndërtuar sipas Vendimeve të Lejeve Ndërtimore 05 Nr. 351-27814/20 dt. 09.10.2009, (faza e parë-pjesa e nëntokës së kompleksit), 05-035-71040 dt. 15.05.2013, (faza e dytë e ndërtimit), 05-035-232898 dt. 20.12.2013 (faza e tretë e ndërtimit) dhe 05Nr.351/05-37066/23 dt. 20.05.2024 (ndryshim-plotësim&zgjerim), të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e

Komunës së Prishtinës, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 7228-1 & 7228-2 ZK. Prishtinë si dhe me trajtim përmes transferit të parcelës kadastrale 7228-3, ZK. Prishtinë.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga menaxheri i vendpunishtes Osman Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Kreshnik Rraci; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Fatos Tahiri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Fadil Balaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Baki Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Pajtim Mustafa; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Erzen Halimi. me nr. të licencës 31 dhe gjeodeti i licencuar Fatmir Ademi me nr. të licencës 26;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e komisionit për pranimi teknik, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Në ndërkohe, aplikuesit, me kërkesën nr. 05Nr.070/01-72839/25 dt. 26.05.2025, kanë kërkuar nga kjo Drejtori ndryshimin e vendimit 05Nr.391/02-37349/25 dt. 08.05.2025, mbi emërimin e komisionit profesional për pranimin teknik të kompleksit të ndërtesave, gjegjësisht është kërkuar ndërrimi i anëtarit të komisionit për çështje juridike me qenë se i njëjti ka qenë i punësuar tek investitori, dhe pas shqyrtimit të saj, me Vendimin 05Nr.391/02-37349/25 dt. 28.05.2025 është miratuar kjo kërkesë.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-së

**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 391/02-37349/25 DT. 29.05.2025**

Zyrtari,  
Berim Osmanaj

